V E N D I M
Nr.664, datë 2.9.1996

PËR PAJISJEN ME PASAPORTË TË RE TË ZAKONSHME PËR JASHTË SHTETIT TË SHTETASVE SHQIPTARË QË NDODHEN ME BANIM JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Duke u mbështetur në ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", Kartën për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, në zbatim të dekretit nr.7393, datë 12.6.1990 "Për lëshimin e pasaportave për jashtë shtetit dhe dhënien e vizave", si dhe nisur nga qëllimi për të realizuar sa më parë në praktikë vendimin e Qeverisë për vënien në qarkullim të pasaportave të reja për jashtë shtetit, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shtetasit shqiptarë që gjenden me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kanë të drejtë të pajisen me pasaportë të zakonshme për jashtë shtetit pranë përfaqësive diplomatike e konsullore të Republikës së Shqipërisë të akredituara në shtetin ku ata kanë vendbanimin.

2. Për pajisjen me pasaportë, shtetasit shqiptarë që përmbushin kushtet e nevojshme ligjore, duhet të paraqiten personalisht në përfaqësitë tona diplomatike e konsullore për të plotësuar e dorëzuar dokumentacionin përkatës, si dhe për të bërë paraprakisht pagesën.

3. Përfaqësitë diplomatike e konsullore, pas pranimit dhe verifikimit paraprak të dokumentacionit përkatës, bëjnë përpunimin e tij dhe i dërgojnë drejtpërsëdrejti Ministrisë së Brendshme, në rrugën më të shpejtë, të dhënat kryesore për kërkesën e çdo shtetasi sipas kritereve të kësaj ministrie.

4. Ministria e Brendshme të marrë masa për të krijuar një strukturë të përkohshme të përballimit të veprimtarisë për marrjen, përpunimin dhe verifikimin e dokumenteve që vijnë nga përfaqësitë tona jashtë vendit dhe plotësimin e dërgimin në destinacion të pasaportave.

Verifikimi dhe plotësimi i pasaportave të bëhet në përputhje me rregullat e vendosura nga Ministria e Brendshme. Pasaportat e plotësuara dërgohen ose drejtpërsëdrejti, ose nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, përfaqësive diplomatike e konsullore, të cilat ua dorëzojnë shtetasve shqiptarë. Në rast se persona të veçantë nuk i plotësojnë kushtet ligjore, përfaqësive diplomatike e konsullore u dërgohet përgjigje negative.

5. Si rregull shtetasit shqiptarë pajisen me pasaportë jo më parë se 1 muaj nga dita e paraqitjes së kërkesës në përfaqësitë diplomatike e konsullore. Në raste të veçanta, mbi bazën e kërkesës së personit të interesuar, paisja me pasaportë mund të bëhet me procedurë të përshpejtuar brenda 2 javëve.

6. Shtetasit shqiptarë me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, që kërkojnë të pajisen me pasaportë për jashtë shtetit, do të parapaguajnë vlerën në dollarë amerikanë, që caktohet dhe u njoftohet përfaqësive nga Ministria e Brendshme. Kjo vlerë do të përbëhet nga çmimi i pasaportës i caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, nga tatimet e taksat sipas ligjeve në fuqi dhe një tarifë shërbimi 30 dollarë amerikanë.

Në rast se refuzimi i pajisjes me pasaportë të një shtetasi ka si shkak të vetëm paraqitjen e të dhënave të rreme prej tij, këtij personi nuk i kthehet pagesa paraprake.

7. Ministria e Punëve të Jashtme, të ardhurat bruto të realizuara nga shitja e pasaportave, i kalon në favor të Ministrisë së Brendshme, përveç 30 për qind të tarifës së shërbimit që i lihet asaj për të mbuluar shpenzimet e operacionit. Ministria e Brendshme derdh në buxhet detyrimet për tatimet dhe taksat.

8. Ministri i Punëve të Jashtme, ministri i Brendshëm dhe ministri i Financave ngarkohen të nxjerrin udhëzim të përbashkët për zbatimin e këtij vendimi.

9. Deri në momentin e fillimit të veprimtarisë me strukturën e re, nga ana e Ministrisë së Brendshme të vazhdojë procedura e mëparshme për pajisjen me pasaporta të shtetasve tanë jashtë vendit.

10. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.598, datë 30.10.1995, me ndryshimet e vendimit

nr.18, datë 15.1.1996, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi